



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
P- 81/25
Prishtinë, më 23 korrik 2009
Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

P R O C E S V E R B A L

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 23 DHE 24 KORRIK 2009

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Ibrahim Gashi**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 81 deputetë dhe shpalli të hapur punimet e seancës.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Në fillim të seancës për fjalë u paraqitën këta deputetë:

Deputeti **Ibrahim Makolli** propozoi që të bëhet ri-radhitje e pikave të rendit të ditës, si në vijim:

Pika nr. 9 dhe pika nr. 10 e rendit të ditës të radhiten si pikë nr. 3, përkatësisht nr.4.

Pika nr. 8 e rendit të ditës të radhitet si pikë nr. 5 dhe pika e bartur nga seanca plenare e 17 dhe 20 korrikut 2009 të radhitet si pika nr. 6 e rendit të ditës.

Kryetari hodhi në votim propozimin e deputeti **Ibrahim Makolli**.

Kuvendi me shumicë votash miratoi propozimin e deputetit Makolli.

Besa Gaxherri tha se ndryshimet në radhitjen e pikave të rendit të ditës, mos procedimi i Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit, si dhe mospjesëmarrja e ministrave në seancat plenare janë shqetësuese për LDD-në.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave të mëparshme,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale,
6. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Parlamentar ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, nga komuniteti serb,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetikë,
9. Shqyrtimi parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-105 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009,
10. Ratifikimi i marrëveshjes për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në organizatat e grupit të Bankës Botërore,
11. Ratifikimi i Marrëveshjes për Përvetësimin e Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim si dhe i Memorandumit të Misionit të Thesarit të Bankës Botërore 23-25 qershor 2009,
12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për shpalljen e hapësirë-zonë me interes të veçantë ekonomik për ndërtimin e hidrocentralit “Zhur”.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare, të 9 dhe 10 korrikut 2009

Kuvendi miratoi pa vërejtje procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur me 9 dhe 10 korrik 2009.

Driton Tali pati vërejtje në transkript, në faqen 44, që është korrigjuar, sipas propozimit të tij.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Driton Tali** parashtroi pyetje për zëvendëskryeministrin ose për ministrin e Ekonomisë e Financave, **Ahmet Shala**, lidhur me Projektin e Qeverisë së Kosovës për afirmimin e imazhit të Kosovës në arenën ndërkombëtare, besuar kompanisë izraelite Saatchi & Saatchi.

Ministri Shala iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Deputeti **Driton Tali** parashtroi pyetje për ministren e Energjetikës dhe Minierave, Justina Shiroka -Pula, lidhur me importin e energjisë elektrike në Kosovë.

Ministrja Shiroka -Pula iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Arsim Rexhepi kërkoi që pyetjen për ministrin Ahmet Shala ta lexojë në seancën plenare të radhës.

3. Ratifikimi i marrëveshjes për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në organizatat e grupit të Bankës Botërore

Kryetari ftoi Kryeministrin e Kosovës që ta prezantojë ratifikimin e marrëveshjes së lartpërmendur.

Kryeministri **Hashim Thaçi**, fillimisht tha se sot është një ditë e veçantë për Kosovën, sepse kemi krijuar mundësinë për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje. Para pak ditësh në Uashington nënshkruam anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Bankën Botërore dhe në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe ky anëtarësim u përkrah nga 138 shtete, 62 prej të cilave e kanë njohur Republikën e Kosovës deri më tani, tha Kryeministri.

Në vijim ai konstatoi se anëtarësimi në Bankën Botërore dhe në Fondin Monetar Ndërkombëtar, paraqet fuqizim të shtetit të Kosovës dhe hap perspektiva për njohje të reja, integritet ekonomike si dhe për integritet në strukturat euro-atlantike.

Ai tha se sipas Kushtetutës, ky anëtarësim duhet të ratifikohet nga Kuvendi i Kosovës dhe i ftoi deputetët për ta votuar ratifikimin e marrëveshjes në fjalë.

Në fund Kryeministri tha se disa detaje rreth kësaj marrëveshjeje do të paraqesë ministri i Ekonomisë dhe Financave.

Ahmet Shala tha se ditë më parë Fondi Monetar Ndërkombëtar ka propozuar ndarjen e re të aksioneve në vlerë prej 43, 7 milionë dollarë dhe se kjo është një shenjë e mirë që Kosova ta ketë të drejtën e tërheqjes, dhe se për këtë kërkohet që guvernatori i BQK-së, të paraqet pjesëmarrjen në FMN, por para kësaj kërkohet që Kuvendi i Republikës së Kosovës ta Ratifikojë marrëveshjen. Më tej tha se një shtet ka të drejtën e tërheqjes së dyfishit të forcës tërheqëse. Ai konstatoi se e drejta e Kosovës është në 159 milion dollarë.

Në fund ai i ftoi deputetët për votim të kësaj marrëveshjeje.

Kryesuesi hapi debatin për ratifikimin e marrëveshjes së lartpërmendur.

Opinione lidhur me këtë dhanë këta deputetë. Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, **Gani Koci**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së **Ramë Buja**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Lutfi Haziri**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Ibrahim Makolli**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli**, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Xhezair Murati**, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, **Kryetari** hodhi në votim ratifikimin e marrëveshjes për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në organizatat e grupit të Bankës Botërore

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----89,
Kundër-----0,
Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë të kualifikuar votash

V E N D O S I

1. Ratifikohet Marrëveshja për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në organizatat e grupit të Bankës Botërore.
2. Ngarkohet Qeveria e Republikës së Kosovës që t'i marrë të gjitha veprimet e nevojshme për realizimin e të gjitha të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësimi i Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në organizatat e grupit të Bankës Botërore.

4. Ratifikimi i Marrëveshjes për përvetësimin e kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim si dhe Memorandumi i misionit të Thesarit të Bankës Botërore, 23-25 qershor 2009

Pasi që nuk pati të paraqitur për diskutim, për këtë pikë, **Kryetari** e hodhi në votim Ratifikimin e Marrëveshjes për Përvetësimin e Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim si dhe Memorandumi i misionit të Thesarit të Bankës Botërore, 23-25 qershor 2009.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----82,
Kundër-----1,
Abstenime-----3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë të kualifikuar votash

V E N D O S I

1. Ratifikohet Marrëveshja për përvetësimin e Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, si dhe Memorandumi i Misionit të Thesarit të Bankës Botërore 23-25 qershor 2009.
2. Pjesë e këtij vendimi është teksti i Marrëveshjes së cekur në paragrafin një (1) të këtij vendimi.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-105 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009

Kryetari ftoi Kryeministrin e Kosovës që në emër të Qeverisë ta prezantojë këtë projektligj.

Kryeministri **Hashim Thaçi** tha se ky rishikim i buxhetit është duke u bërë në kohën kur sapo kemi kaluar gjysmën e parë të vitit 2009. Ky rishikim i brendshëm nuk i lëviz kufijtë përfundimtar të buxhetit për vitin 2009. Sidoqoftë, ai tha me këtë rishikim kemi paraparë implikime buxhetore shtesë në vlerë mbi 120 milionë euro.

Në vijim potencoi se me këtë rishikim kemi paraparë mjete për fillimin e ndërtimit të autostradës Vërmicë – Merdare, gjë që tregon përkushtimin e Qeverisë për një të ardhme më të mirë. Edhe në fushën e arsimit, tha Kryeministri, kemi paraparë mjete shtesë, duke përmendur dhënien e teksteve falas për të gjithë nxënësit, nga klasa e parë deri në klasën

e nëntë, për vitin shkollor 2009/2010, si dhe financimin e rrjetit të kompjuterizimit nëpër shkolla. Po ashtu, tha se mjetet shtesë janë paraparë edhe për listën esenciale të barnave. Në fund ai tha se përkundër krizës globale ne jemi në rrugë të mirë për realizimin e këtij buxheti. Pra, Kosova ka trend pozitiv të rritjes ekonomike dhe sa i përket rishikimit të buxhetit jemi në harmoni edhe me rekomandimet e ekspertëve ndërkombëtarë të kësaj fushe.

Ministri **Ahmet Shala** tha se rishikimi i buxhetit paraqitet para deputetëve pas një ser takimesh të stafit të organizatave buxhetore, që kanë zgjatur më se një muaj e gjysmë. Më tutje tha se objektivi kryesor ka qenë që rishikimi të mbetet brenda parametrave kryesor buxhetor të miratuar, për buxhetin e vitit 2009.

Ai tha se kemi financa shtesë të cilat janë mundësuar nga kursimet, e që kapin shumën 108 milionë euro dhe po thuajse të gjitha organizatat buxhetore përfitojnë nga ky rishikim. Ministri në fund konstatoi se ky rishikim i buxhetit është bërë duke marrë parasysh edhe Kornizën afatmesme të shpenzimeve, kurse në lidhje me rezervat stabilizuese konstatoi se ato janë 200 milion euro.

Në fund ai kërkoi nga deputetët miratimin në parim të këtij projektligji.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtim, në parim, të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-105 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë. Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, **Gani Koci**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Safete Hadërgjonaj**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Lutfi Haziri**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Haki Shatri**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Ibrahim Makolli**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Besa Gaxherri**, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Myfera Shinik**, si dhe deputetët: **Gjylnaze Sylja**, **Armend Zemaj**, **Fatmir Rexhepi**, **Myzejene Selmani**, **Mimoza Ahmetaj**, **Lulzim Zeneli**, **Ibrahim Gashi**, **Agim Veliu**, **Ardian Gjini**, **Driton Tali**, **Rita Hajzeraj**, **Xhevdet Neziraj**, **Qamile Morina**, **Sadik Idriz**, **Riza Smaka**, **Hashim Thaçi**, **Vezira Emrush**, **Zylfi Merxha**, **Njomza Emini**, **Drita Maliqi**, **Ahmet Shala**, **Fehmi Mujota**, **Mark Krasniqi**, **Synavere Rysha**, **Ramadan Gashi**, **Myrvete Pantina**, **Berim Ramosaj**, **Gani Koci**, **Ibrahim Selmanaj** dhe **Lutfi Haziri**, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----62,
Kundër-----30,
Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-105 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009.

Kuvendi ngarkoi këto komisione: Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues; Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi; Komisionin për Komunitete dhe Kthim dhe Komisionin për Integritet Evropian. Komisionet e lartpërmendura duhet që projektligjin ta shqyrtojnë sa më shpejt që është e mundur, nga shqyrtimi i parë dhe Kuvendit ti paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Parlamentar ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, nga komuniteti serb

Kryesuesi ftoi kryetarin e Komisionit Parlamentar ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, që ta marrë fjalën.

Kryesuesi konstatoi se nuk është paraqitur askush për fjalë.

Kryesuesi kërkoi nga grupet parlamentare që ta caktojnë nga një anëtar për Komisionin votues.

Grupet parlamentare propozuan këta anëtarë:

Adem Grabovcin nga PDK-ja, kryetar të Komisionit votues

Arsim Rexhepin nga LDK-ja, anëtar

Rasim Selmanajn nga AAK-ja, anëtar

Suzana Novobrdaliun nga AKR-ja, anëtar

Synavere Ryshën nga LDD-ja anëtar

Enis Kervanin nga “7+” anëtar dhe

Hafize Hajdinin nga SLS, anëtar

.

Pas procedurës së votimit, anëtari i Komisionit votues, **Arsim Rexhepi** i deklaroi rezultatet e votimit, si në vijim:

1. Në votim kanë marrë pjesë gjithsej 92 deputetë,
2. Për kandidaten Irena Svetiç – Ahmedi, kanë votuar 44 deputetë,
3. Për kandidatin Nebojsa Azdejkoviç kanë votuar 40 deputetë,
4. Tetë (8) fletëvotime kanë qenë të pavlefshme.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

1. **Irena Svetiç - Ahmedi**, emërohet anëtare e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.
2. Mandati i anëtarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës zgjat pesë (5) vjet.
3. Vendimi hyn në frutë ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kuvendit.

Kryetari pas pëlqimit nga deputetët vendosi që shqyrtimi i pikave të tjera të kësaj seance të vazhdojë më 24 korrik, në orën 10:00.

Kryetari i mbylli punimet e seancës së sotme në orën 17:55 minuta.

E premte, 24 korrik 2009, në orën 10:00
Vazhdimi i seancës plenare

Seancën plenare e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit Haliti**, anëtari i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 82 deputetë.

Për fjalë u paraqit deputeti **Bojan Stojanoviç**, i cili kërkoi që procedura e votimit të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, nga komuniteti serb të përsëritet, me arsyetimin se duhet të zbatohet procedura e votimit e njëjtë sikurse me rastin e votimit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, nga komuniteti serb.

Kryetari kërkoi deklarimin e shefave të grupeve parlamentare dhe të kryetarit të Komisionit ad-hoc.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Ramë Buja**, tha se nuk mendon se kjo çështje është e arsyeshme të ngritet, por mund të konsultohet ana ligjore.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Lutfi Haziri**, tha se sa i përket dispozitave ligjore çdo gjë është në rregull, lidhur me këtë çështje. Kategoria e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, nga komuniteti serb, nuk bie në grupin e votës së dyfishtë, konstatoi ai.

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, tha se nuk kemi asgjë kundër kërkesës, por duhet të kemi një sqarim ligjor për këtë çështje.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli**, tha se jemi të bindur se seanca plenare lidhur me këtë pikë të rendit të ditës i ka respektuar normat ligjore dhe procedurale. Nëse ka dilema ato mund të sqarohen.

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Xhezair Murati**, tha se e përkrah kërkesën e SLS.

Në emër të Komisionit Parlamentar ad-hoc, **Hydajet Hyseni**, tha se Komisioni ka punuar dhe duhet të punojmë në bazë të akteve ligjore. Në vazhdim tha se përzgjedhja dhe votimi për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës nuk i nënshtrohet procedurës të cilën e kërkoi Grupi Parlamentar SLS. Me ligj kërkohet që dy anëtarë të këtij Këshilli duhet të jenë nga përbërja e minoriteteve dhe se as Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe as Dokumenti Gjithëpërfshirës i Presidentit Ahtisari nuk përmbajnë dispozita të cilat e rregullojnë ndryshe këtë çështje.

Sllobodan Petroviç tha se votimi i djeshëm për këtë pikë ka qenë i kundërligjshëm.

Sabri Hamiti tha se votimi ka qenë i rregullt dhe nuk guxojmë të bëjmë precedent. Pra kjo çështje është punë e kryer.

Gani Koci duke iu referuar Rregullës 3.7 të Pakos së Ahtisarit tha se Kuvendi nuk duhet të krijojë raste të tilla sepse rregulla të tilla nuk ekzistojnë as në Pakon e Ahtisarit dhe as në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Melihate Termkolli tha se ky debat duhet të mbyllet ashtu siç e parashohin rregullat ligjore dhe Kushtetuta. Për këtë çështje nuk guxojmë të bëjmë precedent.

Kryetari kërkoi nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi që gjatë ditës së sotme ta shqyrtojë propozimin e Grupit Parlamentar të SLS-së dhe Kuvendit t’ia paraqes një rekomandim lidhur me këtë çështje.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta prezantojë projektligjin për mbrojtjen e ajrit nga ndotja.

Ministri **Mahir Jagcilar** tha se në vazhden e përkushtimeve të Ministrisë ndaj mbrojtjes së mjedisit, si rezultat është edhe hartimi i këtij projektligji.

Ai tha se ligji ekzistues duhet të ndryshohet dhe se ky projektligj është i harmonizuar me direktivat e Bashkimit Evropian nga kjo fushë. Projektligji ka 42 nene.

Në fund, ai ftoi deputetët që t’a miratojnë në parim këtë projektligj.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtim, në parim, të Projektligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Elhame Hetemi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Zef Morina**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Naim Maloku**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Heset Cakolli**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Shpresa Murati**, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar SLS, **Mursel Halili**, si dhe deputetët: **Mimoza Ahmetaj**, **Sanije Aliaj**, **Luljeta Shehu**, **Gjylnaze Syla**, **Driton Tali**, **Zylfije Hundozi**, **Riza Smaka** dhe **Hashim Thaçi**, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----61,
Kundër-----11,
Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për mbrojtjen e ajrit nga ndotja.

Kuvendi ngarkoi këto komisione: Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor si komision funksional dhe raportues; Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi; Komisionin për Buxhet dhe Financa; Komisionin për Komunitete dhe Kthim dhe Komisionin për Integritet Evropian. Komisionet e lartpërmendura duhet që këtë projektligj ta shqyrtojnë brenda dy muajve, nga shqyrtimi i parë dhe Kuvendit t’i paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta prezantojë Projektligjin në fjalë.

Ministri **Mahir Jagcilar**, tha se banimi është një çështje e rëndësishme për stabilitetin social të një vendi dhe se kjo çështje është e rregulluar edhe me konventat evropiane. Më tej ai përmendi faktin se fondi i banimit në vendin tonë është dëmtuar pothuajse plotësisht. Ndërtimi i banesave të tilla në vendin tonë ka filluar në vitin 2003 nga MMPH-ja dhe nga komunat.

Në vazhdim tha se programet e veçanta të banimit i dedikohen në radhë të parë atyre familjeve të varfra të cilat nuk kanë përfituar deri më tani nga donatorët. Përparësi në këto programe të veçanta të banimit kanë femrat kryefamiljare. Nevojat për banim janë shumë të mëdha për kategoritë e personave me të ardhura të vogla. Ky projektligj, përcakton kriteret për përzgjedhjen e familjeve përfituese, nga këto programe dhe se politika dhe financimi i këtyre programeve bazohet edhe në praktikën e vendeve të rajonit.

Në fund ai ftoi deputetët që ta votojnë miratimin në parim të këtij projektligji.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtim, në parim, të Projektligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Sala Berisha – Shala**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Anita Morina - Saraçi**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Naim Maloku**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Heset Cakolli**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli**, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Sadik Idriz**, si dhe deputetët: **Vezira Emrush, Fatmire Berisha, Hydajet Hyseni, Riza Smaka, Elhame Hetemi, Sabri Hamiti dhe Mahir Yagcilar**, të cilat janë dhënë në transkript, që është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----69,
Kundër-----2,
Abstenime-----1

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për financimin e programeve të veçanta të banimit.

Kuvendi ngarkoi këto komisione: Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor si komision funksional dhe raportues; Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi; Komisionin për Buxhet dhe Financa; Komisionin për Komunitete dhe Kthim dhe Komisionin për Integritet Evropian. Komisionet e lartpërmendura duhet që projektligjin t’ia shqyrtojnë brenda dy muajve, nga shqyrtimi i parë dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta prezantojë Projektligjin në fjalë.

Ministri **Ahmet Shala**, tha se ky projektligj është hartuar në bashkëpunim me komunitetin e biznesit dhe bazohet në praktikat më të mira në rajon. Ai tha se projektligji parasheh harmonizimin e tatimeve si në të ardhurat personale ashtu edhe në të ardhurat e korporatave. Më tej tha se ky projektligj avancoi listën e të ardhurave të përjashtuara, dhe se në këtë drejtim Kosovën e bën vend më atraktiv për investimet e huaja. Po ashtu ky projektligj rregullon edhe: kohëzgjatjen e qëndrimit të kontraktuesit në Kosovë, avancoi rregullat për trajtimin e borxhit të keq, avancoi dispozitat e bartjes së humbjeve tatimore si dhe dispozitat administrative, konstatoi ai. Projektligji ka 11 kapituj me 51 nene dhe është në përputhje me dispozitat për hartimin e legjislacionit. Në fund ministri ftoi deputetët që ta përkrahin miratimin në parim të këtij projektligji.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtim, në parim, të Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së **Safete Hadërgjonaj**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Armend Zemaj**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Haki Shatri**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Riza Smaka**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Sinavere Rysha**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Myfera Shinik**, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar SLS, **Mursel Halili**, si dhe deputetët: **Nekibe Kelmendi**, **Berim Ramosaj**, **Shkumbin Demaliaj** dhe **Driton Tali**, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----68,
Kundër-----2,
Abstenime-----5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për tatimin në të ardhurat personale.

Kuvendi ngarkoi këto komisione: Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues; Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi; Komisionin për Komunitete dhe Kthim dhe Komisionin për Integritet Evropian. Komisionet e lartpërmendura duhet që projektligjin ta shqyrtojnë brenda dy muajve, nga shqyrtimi i parë dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta prezantojë projektligjin në fjalë.

Ministri **Lutfi Zharku**, tha se miratimi i këtij projektligji do të krijojë kushte për regjistrat e topografisë dhe të pronës industriale.

Ai tha se ky projektligj për vitin 2009 nuk ka implikime buxhetore, kurse për vitet e tjera po.

Në vijim tha se projektligji është i harmonizuar me Direktivën nr. 87/54 të Bashkimit Evropian.

Në fund, ministri Zharku ftoi deputetët që ta miratojnë në parim këtë projektligj.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtim, në parim, të Projektligjit për përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Kaqusha Jashari**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Armend Zemaj**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ethem Çeku**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Myzejene Selmani**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Naser Rugova**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Enis Kervan**, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar SLS, **Mursel Halili**, si dhe deputeti **Riza Smaka**, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----65,
Kundër-----0,
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara.

Kuvendi ngarkoi këto komisione: Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion si komision funksional dhe raportues; Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi; Komisionin për Buxhet dhe Financa; Komisionin për Komunitete dhe Kthim dhe Komisionin për Integritet Evropian. Komisionet e lartpërmendura duhet që projektligjin ta shqyrtojnë brenda dy muajve, nga shqyrtimi i parë dhe Kuvendit t’i paraqesin raportet me rekomandime.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetikë

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta prezantojë Projektligjin në fjalë.

Zëvendëskryeministri **Hajredin Kuçi** tha se beson që deputetët ta kenë marrë projektligjin me kohë, ta kenë lexuar dhe i ftoi ata për miratim në parim të këtij projektligji.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtim, në parim të Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetikë.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Edita Tahiri**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Fatmir Rexhepi**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Donika Kadaj-Bujupi**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Myzejene Selmani**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Naser Rugova**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Sidik Idriz**, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar SLS, **Bojan Stojanović**, si dhe deputetët: **Ibrahim Makolli**, **Ardian Gjini** dhe **Riza Smaka**, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----81,
Kundër-----0,
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetikë.

Kuvendi ngarkoi këto komisione: Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion si komision funksional dhe raportues; Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi; Komisionin për Buxhet dhe Financa; Komisionin për Komunitete dhe Kthim dhe Komisionin për Integritet Evropian. Komisionet e lartpërmendura duhet që projektligjin ta shqyrtojnë brenda dy muajve, nga shqyrtimi i parë dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për shpalljen e hapësirës-zonë me interes të veçantë ekonomik për ndërtimin e hidrocentralit “Zhur”

Kryetari ftoi ministren e Energjetikës dhe Minierave, që ta prezantojë Propozim-vendimin në fjalë.

Justina Shiroka – Pula, tha se lidhur me ndërtimin e hidrocentralit “Zhur”, Qeveria e Kosovës ka themeluar Komitetin ndërministror. Ky Komitet ka përcjellë studimin e fizibilitetit dhe rezultatet e konkluzave të këtij studimi qojnë në konstatimin se kjo hapësirë duhet të shpallet – zonë me interes të veçantë ekonomik, në një sipërfaqe prej mbi 19 hektarësh, konstatoi ajo.

Më tutje tha se miratimi i këtij propozim-vendimi të Qeverisë, i hap rrugë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për hartimin e planit hapësinor për këtë zonë.

Kryetari hapi debatin për Shqyrtimin e propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për shpalljen e hapësirës-zonë me interes të veçantë ekonomik për ndërtimin e hidrocentralit “Zhur”.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë propozim-vendim dhanë këta deputetë: Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së **Sala Berisha-Shala**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Armend Zemaj**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ethem Çeku**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Heset Cakolli**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Naser Rugova**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Sadik Idriz**, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar SLS, **Bojan Stojanoviç**, si dhe deputetët: **Vezira Emrush** dhe **Ardian Gjini**, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij propozim-vendimi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----69,
Kundër-----8,
Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash mori

V E N D I M

1. Shpallet zonë me interes të veçantë ekonomik hapësira në sipërfaqe prej 19.41 km² për ndërtimin e hidrocentralit “Zhur”, sipas hartës së bashkangjitur.
2. Zona e interesit të veçantë përfshin komponentët kryesor që janë identifikuar në studimin e fizibilitetit për ndërtimin e hidrocentralit “Zhur”.
 - Prurjet e rrjedhjeve nga vargmalet e Sharrit (tunelet gravituese, kanalet, akuaduktet dhe sifonet);
 - Akumulimi artificial Plavë;
 - Akumulimi artificial Brezne;
 - Hidrocentrali “Zhur I” (objekti i hidrocentralit, tunelet me presion, gypi i çelikut me presion, kyçja në rrjet);
 - Hidrocentrali “Zhur II” (objekti i hidrocentralit, kanali i mbyllur, tuneli gravitues, gypi i çelikut, kyçja në rrjet);
3. Qëllimi i shpalljes zonë me interes të veçantë, është:
 - Zhvillimi dhe shfrytëzimi i kontrolluar i zonës, duke ofruar mundësinë për ndërtimin e hidrocentralit “Zhur”;
 - Mbrojtja e zonës ujëmbledhëse dhe rrjedhjeve të lumenjve (me degët): Plavë, Brod, Restelicë dhe Çajlanë;
 - Përmirësimi i kushteve për zhvillimin e turizmit dhe aktiviteteve të tjera ekonomike në zonën përreth.
4. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor që të hartojë planin hapësinor për këtë zonë.
5. Qeveria e Kosovës duhet t’i marrë veprimet e nevojshme për realizimin e këtij vendimi.

Në lidhje me rekomandimin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, ndaj kërkesës së Grupit Parlamentar SLS, **Kryetari**, ftoi kryetarin e këtij Komisioni, që ta marrë fjalën.

Bahri Hyseni tha se Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në marrëveshje me Grupin Parlamentar SLS, është pajtuar që rekomandimin t’ia paraqes Kuvendit në njërën nga seancat plenare, të sesionit vjeshtor.

Seanca i përfundoi punimet në orën 16: 58 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: **Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale**